KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

Mbledhja e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VII , mbledhja e IX) me dt.30.10.2024

DEÇAN

e Mërkurë, 30 Tetor 2024

Hajdar Sutaj

Të nderuar kolegë përshëndetje, e hapim takimin e 10-të të rregullt të kuvendit komunal, ashtu siç edhe jeni nënshkruar në listën e prezencës, nga 27 antarë që i ka kuvendi, 3 mungojnë që janë 24 anëtarë edhe konstatojmë se ka kurum të mjaftueshëm me vazhdu me punimet e kuvendit, seancës së kuvendit komunal, ashtu siç e keni marë edhe materialin, i kemi këto pika për diskutim.
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nën 2 është shqyrtimi i raportit 9 mujor financiar, nën 3 është shqyrtimi i draft planit zhvillimor të arsimit 2024-2027, e te të ndryshmet ja u kemi bashkangjitur një kërkesë të cilën ju e vlerësoni kuvendi nëse do të jetë pikë e rendit të ditës, që ka të bëjë me krijimin e komisionit për ndarjen e bursave.
Po ashtu dhe komisionit për ankesa, ndërsa, po ashtu më lejoni që të ju njoftoj që e kemi një shkresë prej ministrisë së administrates, që ka të bëj me vendimin, me shfuqizimin e një vendimi që e kemi marrë me datën 19.08.2024, ku vjen pika te të ndryshmet, e diskutojmë edhe ju njoftojmë sa i përket rendit të ditës.
A ka dikush diçka me diskutu? Po Vatan Istrefaj, urdhëro mikrofonin.

Vatan Istrefaj
Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë.
E kemi bërë edhe 1(një) rekomandim në komitetin politik financa rreth rendit të ditës së seancav, ku rekomandoj se kuvendi tek pikat e të ndryshmeve të del si pikë e pare e rendit të ditës në mbledhjen e kuvendit, me arsyetim se në fillim të mbledhjes janë prezent në sallë kryetari dhe ekzekutivi komunal dhe transparenca është më e madhe, pasiqë, nëse mbet pika e ndryshmeve për në fund të ditës, atëherë, kryetari ndoshta ka edhe angazhime dhe shpeshherë po e liron sallën, kështu që me mirëkuptim, kjo kërkesë ka qenë edhe njëherë po asamblistit Mon Selmanaj kërkoj që ky rekomandim të dalë në votim, faleminderit!

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë, Faton Selmanaj pastaj Albesa Cacaj.

Faton Selmanaj
Përshëndetje për të gjithë, kryesues, rekomandimet e komisionit për politikë e financa, nuk na kanë ardhur sod, kish me qenë mirë, me na i sjellë edhe qaj vendim që e potencove i ministries, pse nuk na ka ardhur neve?

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë, Albesa?

Albesa Cacaj
Në rregull, faleminderit zotëri kryesues, çështja ka të bëjë pse nuk është në rend të ditës, raporti i performancës komunale? Duke marrë parasysh se ky raport është publiku në faqet e ministrisë 01.08.2024, pra është raporti i performancës komunale për vitin 2023 dhe që është obligim ligjor me u diskutu në kuvend. Pra nuk votohet, por diskutohet, gjithashtu edhe zonja Ajna, zyrtarja për barazi gjinore kur e ka sjellë planin komunal për barazi gjinore te fletat e fundit për monitorim dhe zbatim është e theksume që 1 herë spaku, 1 herë brenda vitit kryetari i komunës të vije në kuvend dhe të na raportoj mbi zbatimin e arritshmërisë së objektivave të këtij plani edhe ky është i paraparë në planin e punës së kuvendit. Për vitin 2024 është i parapam ka qershori, po kane kalu qershori, korrik, shtatorit dhe nuk ka qenë ende present.
Kërkoj shpjegim, pse ndodh kjo kur vetë e bëni planifikimin e planit të punës dhe bini ndesh në moszabtushmëri të tij, faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit, kryetar mirësevini, po Faton Selmanaj edhe një here.

Faton Selmanaj
Faleminderit, kërkoj falje se rekomandimet paskan ardhur, por, nuk isha në ulëse kur i ka shperndarë andministrata dhe nuk i kam parë.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë, dikush tjeter, Mifat Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj
Faleminderit shumë kryesues, lidhur me të njëjtën çështje që e potencoi, Faton dokumentin të cilin ju e keni përpara lidhur me shfuqizimin, mirë me lutë sekretarin, që teknikisht nëse ka mundësi me na shpërnda para se me ardh te pika e te të ndryshmëve, faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë, kështu po përgjigjem pak sipas radhës, Po filloj prej Vatonit, Vaton e dini që ligji thotë që kryesuesi bashkë me kryetaren e kuvendit, realisht me kryetarin e komunës bëjnë rendin e ditë dhe kjo është kompetencë e kryesuesit dhe kryetarit të komunës që më hartu dhe me rendit pikat e rendit të ditës nëse ka ndonje uregjenc na edhe zhvendosem me pajtueshmërinë e anëtarëve të kuvendit Po faleminderit, Fatoni po ashtu edhe Miftari patën të drejtë në lidhje me vendimin që e ka kthyer ministria për shfuqizimin e një akti që ka marë kuvendi i komunës që është me 31.07, por me thanë të drejtën sekretaria sod më ka njoftuar edhe mu personalisht edhe mendoj që hera të tjera le të jetë ky 1 rekomandim publik që t'ia përcjellim domethanë ta skanojnë ta përcjellin edhe te anëtarët e kuvendit me kohë, por gjithsesi e kisha lutë Vjollcën që me marë me bo kopje dhe me u shpërnda domethonë gjithë anëtarëve të kuvendit. Në lidhje me kërkesën që e tha Albesa realisht nuk e kanë sjellë, nuk e kanë sjellë këta por gjithsesi le të jetë rekomandim dhe procesverbal që me shti në mbledhjen e radhës. Po ashtu rekomandimet kpf-s kanë ardhur po rekomandimet kanë të bëjnë me pika të caktume q i diskutojm kur vimë te pikat e rendit të ditës.
Kush është për këtë rend dite?
A ka kundër?
A ka abstenim?
Konstatoj që kuvendi e ka miratuar rendin e ditës, vazhdoi me pikën e parë sa i përket transkripteve a ka dikush diqka me thanë? Mir se keni ardhë dhe për juve dhe për gjithë mundësisht që telefonat ti bëni që mos të kenë zë nëse ka dikush ndonjë urgjencë mundet me u lajmru edhe jashtë Atëher nuk kemi diqka sa i perket transkriptës, Faton Selmanaj e ka fjalën.

Faton Selmanaj
Faleminderit kryesues, rreth transkriptit nuk kam, por rreth transmetimit të seancave, seancën e fundit është shkëput transmetimi me arsyetimin që ka pas problem me rrjetin, ndërsa ai gjirim nuk është transmetu. Po ashtu, ka edhe seanca tjera, që transmetuesi nuk ka qëndru deri në fund të seancës dhe ish kon mirë të na jep përgjigje dikush, përse po ndodhin këto.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë, është shqetësim shumë më vend, unë personalisht i kam dërgue 1 letër vrejtje agjencionit të cilët atë ditë e kanë bërë pengesë, kam parë prej kolegëve të cilët i kanë dhënë edhe orientim tjetër, është normal që këto janë politika që bën gjithsecili, po ka qenë vërejtje është vërejtje për transmetuesen, edhe po ashtu e thamë publikisht që nuk ma kanë përcjell videon, sepse atë ditë, kam kërkuar që me na përcjellë domethanë incizimin. Edhe me përjashtim 2 seancave të para që i kanë inçizu as nje transmetim nuk e kanë përcjellë, edhe sot kërkova edhe prej zyrtarit që është present, që mi përcjell edhe kërkova po ashtu edhe prej menaxheres projekt kontratës. Ju e dini, ate dite që edhe derisa ka fillu transmetimi, nuk e kom fillu seancën, dhe prap se prap ka pasë pengesë, kam qenë në gjendje edhe me blloku, por prapëseprapë, diçka nuk e di unë, nuk e kuptoj këtë natyrë të punës dhe më vjen keq për këtë që ka ndodhë, atëherë Orges Tafilaj e ka fjalën.

Orges Tafilaj
Faleminderit kyresus, fillimisht pe marrë fjalën me ju përgjigj shqetësimit të kolegëve se menduan se nuk po flas në lidhje me transkriptin, ajo që kam thënë është përfshirë, megjithatë prapë problemi është te lekturimi për shkak të pikësimit. Ndërkohë, në lidhje me çështjen që u diskutua nga Fatoni dhe shqetësimit që ju bashkove edhe ti, besoj është mirë me i pa edhe njëherë kushtet e kontratës, po njëjtën kohë ose me na i sjellë neve kushtet e kontratës këtu me diskutu bashkarisht. Cila është zgjidhja më e mire, ose me diskutu ketu ose diku tjetër, sepse po përsëritet tërë kohën falëmnderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë, sa i përket transmetimit të seancave kem pasë veç këtë mbledhjen e fundit, domethënë atë penges dhe një herë na ka ndodhur qe te ndryshmet është ndërpre edhe atëherë ju e dini që kam reagua aty për aty.
Faleminderit e qes në votim transkripten e mbledhjes së kaluar.

Kush është për?
A ka kundër?
A ka abstenim?
Konstatoj që kuvendi e ka miratuar në mënyrë unanime proces verbalin, në këtë rast transkriptin nga mbledhja e kaluar, jemi te pika e 2-të që është shqyrtimi i raportit 9 mujor financiar fillimisht ia kaloj fjalën drejtoreshës për buxhet dhe financa, zonjës Dafina Cacaj, e pastaj e hapim debatin te shefat e grupeve dhe te anëtarët e kuvendeve drejtoreshë fjala për ju.

Dafina Cacaj
Mirmëgjes për të gjithë, komuna e Deçanit në raportin 9 mujor financiar dhe shpenzimeve e ka pasqyruar shpenzimet që janë kryer për këta 9 muaj, domethonë edhe realizimin e të hyrave, te realizimi i të hyrave komuna ka realizuar 70.97% të hyrave janë pa tremujorin e 2-të të gjobave në trafik, për shkak se ato vijnë pak më vonë se sa të hyrat tjera dhe nuk janë pasqyruar këtu. Ndërsa, shpenzimin e buxhetit e kemi 87,19% që domethënë kemi arrit shkallën 70% sa është edhe norma e përcaktuar me ligj. Shpenzimet janë përafërsisht të njëjta sikur gjashtëmujorin e 1-rë ka ndryshime të vogla për disa kategori për të cilat kemi bërë shpenzime nuk i kemi buxhetin sa e kemi në fillim të vitit, fund të vitit është buxheti pak më i vogël e nëse keni pyetje ose doni sqarime shtesë, unë edhe kryteri jemi këtu muni me na u drejtuar nuk po hy për secilen veq e veq, se veq e keni raportin përpara por nëse keni pyetje ktu jemi faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit drejtoreshë, siç e dini jo pse e kemi me rregullore por e kemi bërë praktik që të ketë deklarime prej grupeve të asamblistëve, pastaj e hapim diskutimin te anëtarët e kuvendit nga grupi i Aak-s a dëshiron dikush diçka më thanë Arjan Dobraj, shef i grupit.

Arjan Dobraj
Faleminderit i nderuar kryesues Hajdar, i nderuar kryetar, të nderuar gjithë të pranishëm.
Raporti financiar si një nga pikat më të rëndësishme do të thotë që përfaqëson 1 nga proceset e kuvendit komunal në Deçan faktikisht e mbështesim në përgjithësi dhe në parim patjetër, sepse është 1 punë mirë e detajuar e kategorizuar nëpër sektorë në mënyrë të drejtë dhe të saktë siç e tha drejtoresha, për shkak se edhe e ka plotësuar normën e shpenzimit të buxhetit që varion domethonë nga shifrat 87% faktikisht si grup në fakt jemi pro për këtë raport financiar të detajuar se sa është edhe mirë qartësuar nuk kam diçka tjetër me shut faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë, nga grupi i Ldk-s, Albesa Cacaj.

Albesa Cacaj
Përshëndetje edhe një herë për të gjithë përgjigjet atëherë sa i përket raportit financiar për 9 mujorin e vitit 2024 ja vlen mu theksu nga ato qe i kemi nxjerrë. Raporti financiar është mekanizmi kryesor i monitorimit të buxhetit të komunës, përmes së cilit bëhet informimi mbi ecuritë dhe përmbushjen e planeve të grumbullimit të të hyrave dhe përmbushjes së obligimeve të planifikuara, si dhe mënyrat e shpenzimit të parasë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore. Ky raport të nderuar paraqet 1 raport që ka munges të detajuar të informata financiare dhe rrjedhimisht mungesë të informatave të nevojshme për 1 gjykim të drejtë, për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e proceseve financiare auditori i jashtëm për komunën e Deçanit vazhdimisht ka dhënë rekomandime që komuna të ndërmarrë veprime konkrete me qëllim që të reflektojë dhe të ofrojë sigurinë e nevojshme që paraja publike të shpenzohen në përputhje me planifikimin dhe qëllimin e synuar, e jo siç ndodh në këtë raport financiar dhe në raportet paraprake që mjetet e destinuara nga kategoria e investimeve të ndryshme, si për shembull investimet kapitale të përfundojë te pagesat për vendimet gjyqësore dhe si pasojë e keqplanifikimit e keqmenaxhimit te buxhetit nga ekzekutivi komunal projektet kapitale të cilat fillojnë të mos përfundojnë brenda afatit dhe ato të cilat janë të planifikuara të mos fillojën fare. Nisur nga kjo marrim për bazë gjithmonë raportet të cilat përsëriten ose më mirë të themi kodet, duke u nisur nga fakti se na si lidhje demokratike e Kosovës vazhdimisht kemi kërkuar që raportet të jenë më transparente sipër ne këshilltarët ashtu edhe për qytetarët, të cilët na ndjekin dhe janë, kanë të drejtën e tyre të dinë se si shpenzohet paraja tyre. Për shembull pajisje tjera informative asnjëherë nuk e kemi pas qartë pse nuk theksohen, nuk saktësohen cilat pajisje tjera informative pastaj 1 buxhet i komunës së Deçanit i cili ka qenë i planifikuar n'baza 12 milion të shpenzohet rreth 100.000 euro për 9 muaj telefoni mobile kjo është për keqardhje ku vlen të theksohet se nxancat në komunën e Deçanit, Lidhja e Prizrenit

vijojnë mësimin në kushtet Nëse keni mundësi me e vazhdu se në emer të grupit është duke folur gjejn luksin me paratë e taksapaguesve me i shpenzu rreth 100.000 euro telefoni mobile.
Pastaj kemi vendimet gjyqësore, shërbimet e veçanta, shërbime këshillëdhënëse, mos të harrojmë i nderuar kryetar se auditor i jashtëm vazhdimisht me vitet tana ta saktëson dhe ti japë rekomandim që mos angazho me kontratë mbi vepër kur i ke zyrtar që ta bëjnë atë punë, përveçse nëse e ki kërkesë nga njësiti caktuar kjo nuk është formë e punësimit, kjo është formë e degradimit dhe keqplanifikimit e keq shpenzimit të buxhetit kaq kishim faleminderi.t

Hajdar Sutaj
Faleminderit Albesa, nga vetëvendosja Faton Selmanaj e ka fjalën.

Faton Selmanaj
Faleminderit kryesues, kjo formë e raportit ka rreth 3 muaj që na vjen si e tillë edhe pse insistimi jonë ka qenë i vazhdueshëm që të na vjen në forma e cila ka ardhë deri para 3 muajsh në mbledhjen e komisionit për politika e financa drejtoresha ndër të tjera mu drejtu që dhe na nuk kemi të drejtë me shpalosë në detaje para qytetarëve në rregull po e marrë si të mirëqenë kushtimisht po thamë at konstatim të drejtoreshës jo nuk po e shtrembëroj e po mundohna pavarësisht që e keni kamufluar shumë këtë raport, nëse mundem i thanë po mundona me zbërthy për këta 7 minuta sa më takon me fol këtu dhe kush ka interes mund pastaj edhe më pa. Zyra e kryetarit për këta 9 muaj i ka shpenzuar 652.087 euro pikë 16 cent nuk e di në qfar i ka shpenzuar saktësisht, veç në telefoni mobile 37.287 euro e 40 cent, shërbime të veçanta konsulente dhe kontraktorë individuale 26.383 euro e 25 cent furnizime për zyre, 28.878 euro e 60 cent mirëmbajtje rutinore 45.669 euro e 30 cent kompensimi i përfaqësimit brenda vendit 12.963 euro e 60 cent subvencione për entitente publike 65.500 euro subvencione per entitente jopublike 35.600 euro vendimet gjyqësore 9.500 euro transport për udhëtime zyrtare jashtë vendit 5.460 euro prap furnizim për zyre 16.324 euro shpenzime për informim publik 2.792 euro kompensim i përfaqësimit jashtë vendit 3.584 euro e 98 cent. inspeksioni Deçan pastaj 36.379 euro e 86 cent kompensimi përfaqësimit brenda vendit 1.791 euro te prokurorimi 25.700 euro e 61 cent shtesa të veçanta për të zgjedhurit 25.139 euro e 47 cent kompensimi përfaqësimit brenda vendit 2.781 euro shpenzime këshillëdhënëse dhe profesionale 45.197 euro e 61 cent shpenzime të veçanta konsulente dhe kontrata individuale, 13.962 euro kompensim i përfaqësimit brenda vendit 11.000 euro vendimet gjyqësore, 525.853 euro e 86 cent pagesa për vendimet gjyqësore prap 10.000 euro kompensim i përfaqësimit brenda vendit 10.627 euro vendimet gjyqësore prapë 103.859 euro e 19 cent kompensim i përfaqësimit brenda vendit 4.108 euro kompensim i përfaqësimit brenda vendit 1.981 euro shërbime të veçanta konsulente dhe kontraktuar individuale 5601 euro e 15 cent vendime gjyqësor 9.199 euro ndërtesat shëndetësore 25.000 euro, kom drejt 7 minuta qfar du me thane. Vendimet gjyqësore 10.000 euro po tash drejtoresha ka thanë që nuk ke drejt me fol publikish, tash un po flas në sallë kush don me na përcjell para kamerav e ka mundësin tash transferet sociale për individ 28.800 euro akomodim për udhëtime zyrtare jashtë vendit 2.874 euro, shpenzimet e tjera për udhëtime jashtë vendit 4.266 euro shpenzimet e tjera shpenzime këshillëdhënëse dhe profesionale 8.630 euro ndërtesat administrative dhe afariste është kod qe nuk mundesh as me ditë për qfar u kry kjo pagesë 49.682 euro dhe në fund është kompjuterët që keni blerë 16.560 euro prap kaloj te furnizimet për zyre 115.972 euro furnizimet e pastrimit 49.520 euro e 48 cent vendimet gjyqësore 883.330 euro e 18 cent. Kryesues krejt për fund kërkesa ime është e njëjta që ky raport të vjen i detajum që të jemi të mirë informuar se në çfarë po shkojnë taksat e qytetarve, qfar pagesash qfarë shpenzimesh.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Faton, zotri Mon Selmanaj

Mon Selmanaj
Faleminderit kryesues, të nderuar të pranishëm të nderuar kolegë. Çdo raport cilido qoftë ai që vjen në kuvend këtë rast 1 raport financiar ka për qëllim të njoftojë organet ekzekutive dhe kuvendi komunal për realizimin e buxhetit komunal duke përfshirë buxhetin e secilës drejtori veç e veç ky raport 9 mujor i ardhur në këtë formë e që na paraqet planifikimin e buxhetit për 2024 dhe shpenzimin e këtij buxheti sipas kategorive ekonomike mendoj se nuk është transparent sa duhet për kuvendin dhe publikun, është hera e 3-të apo raporti i 3-të që e kundërshtoi formën e tij të ardhur në kuvend arsyeja është se përveç kodeve ekonomike nën programeve dhe shumat e shpenzuara sipas këtyre kodeve nuk kemi asnjë të dhënë tjetër që dëshmon shpenzimin e parasë publike nuk janë transparente datat e faturimit pagesave të ndara sipas muajve etj. Këtu hasim në një kod ekonomik, për shembull furnizimi me ushqim dhe pije jo dreka zyrtare në kllapa në shumën prej 35.237 euro Unë e shtrojë si pyetje çka nënkupton kjo ose në cilin kod ekonomik shihen atëherë drekat zyrtare? Nuk besoj

që për 9 muaj nuk ka asnjë shpenzim nën programin derivatet për automjete, gjeneratorë dhe makineri janë të bashkdyzuara të gjitha shpenzimet dhe na është pamundësuar ta dimë secilin shpenzim veq e veq për këto nënprograme. Të nderuar, nuk dua të lëshohem në vendimet gjyqësore e përmbarimore, të cilat vetëm për 9 muaj e tejkalojn shumë mbi 4 milionë euro për shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit për shërbimet e veçanta konsulent dhe kontraktori individual, kompensimet e përfaqësimit brenda vendit etj. Për të gjitha këto e shumë të tjera në këtë raport lënë vend për të dëshiruar dhe kisha kërkuar disa sqarime prej këtyre çështjeve që i ngrita nga kryetari ose përfaqësuesi i saj nga zyra e financave faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Mon më falni, ju e dini që kryetari ose drejtoresha per buxhet e financa ka drejt mbas qdo diskutuesi me kërku fjalën fillimisht po ja kaloj fjalën drejtoreshës Dafina Cacaj që me u përgjigj në këto të cilat i ngritën kolegët nga kuvendi pastaj po e vazhdojm debatin me anëtar të kuvendit , drejtoresh fjala për ju ja lëshoni mikrofonin te ulësja

Dafina Cacaj
Po du me sqaru diçka nuk janë shpenzime një mujore janë shpenzimet nëntë mujore ne sidomos telefoni mobile e kemi diskutu edhe tremujorin e 1-rë. Kan qenë obligimet që janë paguar në fillim të vitit tani shpenzimet çdo muaj qe kan ardhur secilën familje të juaj besoj i keni pas shpenzime mujore nëse keni pasur 500 euro në muaj deri tash ju kan bërë 5000 euro dhe këto nuk janë shpenzime për 1 muaj, por janë për 9 muaj rresht edhe nuk kom thonë qe nuk kemi drejtë me diskutu po kom thonë nuk është etike nëpër kafe me u diskutu raporti, nëse doni me diskutu, e këtu mundemi me diskutu në qdo form që ju e vlersoni. E shpenzimet secila e ka kodin e vet e kemi diskutu edhe ma herët nuk është ndoshta ma i miri që i përshtatet ati shpenzimi sikur është pajisje teknologjike ose pajisjet që kan qenë kompjuterat furnizimi për pastrim ose qysh do që jan të shkruara nuk i kemi shkruar ne, ne ju pershtatemi edhe shpenzimet që ai diskutum drejtori për drejtori, ata at buxhet e kanë pas dhe duhet mu shpenzu për shpenzimet operative dhe qdo shpenzim që është e nevojshme për drejtori nuk do me thonë që kryetari nëse ka shpenzuar 30.000 euro kompjutera nuk janë blerë veç për kryetarin, por janë shpenzu te drejtoria, te zyra e kryetarit është paguar obligim i të gjitha drejtorive ndoshta ose nëse ka qenë renovimi i kësaj salle, ose çkado qoft, ose qysh ishte pagesa për informim, është pagesa për televizionin që i përcjell seancat dhe çdo aktivitet që na e mbajm bëhet prej drejtoris ku janë mjetet këtë rast është bërë nga zyra e kryetarit ka mundur te behet nga asambleja ose kujt do qoft, nuk janë shpenzime që i bën personalisht kryetari ose një drejtor, por janë shpenzimet e përbashkëta të tanve sikur komisionet ose çkado që paguhej, paguajë ku janë mjetet nuk i marr une veçse të asambleja nuk janë tën ato pare, për me mujt me pagu une çdo komision që është bo edhe unë kom mujt me pagu kete vit, se veq një komisioni ndoshta është paguar per një herë është paguar 3.000 euro nëse është paguar 6 herë ka 3.000 euro janë bukur do pare për me mujt me i pasë asambleja me pagu diçka tjetër unë nuk kam nëse keni pyetje tjera është edhe kryetari faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë drejtoreshë sipas radhës Vatani, Blinera, Teuta pastaj Syla pastaj Miftari kështu janë lajmëruar Miftar përpara.

Vatan Istrefaj
Faleminderit kryesus po filloj së pari me 1 korrigjim tek përgjigjet e drejtoreshës. Na drejtohesh, nuk kemi diskutu në kafe atë dit po kemi diskutu njërën prej komiteteve më të rëndësishme në komunën, në komitetin politik dhe financa. Po ashtu derisa ky raport të vijë në këtë formë në kuvend atëherë diskutimi gjithmonë se do të jetë më i zgjatur, edhe pse kolegëve këtu nga pozita nuk ju pëlqen shumë që ndoshta kanë punë më të rëndësishme por propozimi me kyç është që të vijë raporti i detajuar, pasi se kjo lënë shumë për të dëshiruar, si për shembull te kodi buxhetor përfaqësim i përfaqësimit kompensim i përfaqësimit brenda vendit është pothuajse në çdo drejtori dhe këtu na spjegoni saktë se çfarë përfshinë këtë kompensim të përfaqësimit brenda vendit, a janë vetëm dreka zyrtare se është lluks i komunës pra këtu e jeni munduar me kamuflu nifar forme apo është edhe ndonjë meditje diçka tjetër. Për njërën prej pikave që më prek më së shumti mua personalisht prej vendime përmbarimore është tek shëndetësia, si për shembull për këtë periudhë kohore përmbaruesi i ka marrë aty 78.726 euro, vetem vendime përmbarimore nëse nuk i kishte marrë përmbarues këto mjete financiare ku do të kishin qenë të destinuara pra, pasi që është për keqardhje, sepse në qendrën kryesore të mjekësisë familjare shpesh here pothuajse gjatë gjithë kohës nuk kemi barrna esenciale e lëre më edhe shiringa, kam edhe fotot e pacientëve që po na i dërgojn duke i dërguar nëpër barnatoret private për shkak të etikës menaxhimi për të blerë edhe shiringa, pra qytetarët tonë, faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Vaton, Blinera Lokaj.

Blinera Lokaj
Faleminderit kryesues përshëndetje për të gjithë, atëherë për vlerësimin dhe gjykimin korrekt të 1 raporti financiar informacioni i dhënë në raport duhet të jetë i saktë i besueshëm, si dhe i interpretuar në mënyrë të drejtë. Duke iu referuar kësaj forme të raportit hasim në kode të paspecifikuara e të paqarta pagesa duke mos respektuar linjat buxhetore, si dhe duke paguar aktivitete që nuk lidhen fare me drejtorinë përkatëse, unë e kam analizuar raportin financiar analitik që e keni të publikuar në veb faqe ku shpenzimet për dreka zyrtare për 6 muaj janë plot 40.000 euro, të cilat janë të paguara jo vetëm nga kodi drekë zyrtare, por edhe nga kodi apo përshkrimin që figuron në raport shpenzim i përfaqësimit brenda vendit vetëm se kodi është i njëjtë 14310 vetëm se dallon përshkrimi. Nëse nisemi nga kjo logjikë, i bie që të gjitha shpenzimet për dreka zyrtare janë të paguara me kodin kompensim i përfaqësimit brenda vendit, e që në total për 9 muaj janë plot 60.000 euro, pra për me bë një analizë më të thelluar, neve na nevojitet raporti i qartë i detajuar, si dhe mbi të gjitha transparent.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Blinera, Teuta Neziraj.

Teuta Neziraj
Atëherë përshëndetje për të gjithë përshëndetje kryetar përshëndetje kryesues të nderuar asambleist dhe gjithë të pranishëm, une kisha kërku nga kryetari me marrë një përgjigje pak më të sakt tek shpenzimet e telefonisë mobile sepse është 1 shumë goxha e majme të themi e jo një përgjigje banale që na jep edhe vetë drejtoresha që nuk po du me cilësu si të tillë por është, edhe pyetja ime specifike është te këto 2 kode ekonomike mirëmbajtja rutinore dhe pajisje tjera çka përfshihet në këto shpenzime, sepse janë shuma të larta dhe nuk e dimë saktë çka faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Teuta, Sylë Balaj.

Sylë Balaj
Atëher përshëndetje për të gjithë, thuajse shumicën i thanë edhe kolegt un veq kam një pytje për drejtorin e bujqësis për një pages. Drejtoria e bujqësisë ka shpenzuar 4.100 euro për kompensim të përfaqësimit brenda vendit qfarë nënkupton kjo drejtor faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë Miftar Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj
Faleminderit shumë kryesues, normal raporti i shpenzimeve është detyrë e kryetarit të drejtoris për financa, ndërsa obligim i asamblesë për ta trajtuar nuk është ndjenjë e mirë nëse hezitojmë të trajtojmë për shkak 2 gjëra jo të mira për shkak të përmbajtjes dhe formës, është hera e 3-të u potencua edhe nga kolegët që forma dhe përmbajtja është jo në ato qe kem pas paraprakisht, emërtimet të pa sakta emërtimet të pakuptueshme dhe për cilat detshe apo s'detshe mundet met dergu te një dyshim që këto eventualisht mund të fshihet diçka. A ka shpenzime apo tejkalime absolut që është është e natyrshme sa do që mund ta mshefin është e pakuptueshme, e në kohë të sodit me një teknologji që për telefoni mobile në një zyrë të kryetarit paguan 37.000 euro, kurse sot kemi forma të ndryshme të komunikimit. për këtë arsye ish dashtë të jetë raporti paraprak para 3 muajve që të jetë më i sakte dhe ne ta dimë kur është bërë ajo faktur dhe kur u bë aj shpenzim sinqerisht është për keqardhje faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Miftar dikush tjetër Orges Tafilaj e ka fjalën.

Orges Tafilaj
Faleminderit kryesus, përshëndetje për të gjithë kolegët. Fillimisht, po besoj, meqenëse po shihet që është pajtimi i të gjithëve, që për herat e ardhshme me na ardhe raporti analitik financiar, si i tillë si na ka ardh, kemi

një mangësi, sepse kjo është një pjesë, pjesërisht një pjesë e raporteve financiare të komunës dhe duke mos e pasë bilancin e gjendjes, normalisht që vijmë edhe në konkludime që mund të jenë të gabuara. Fillimisht u përmendën shumë shpenzime dhe shuma marramendse. Fillimisht, po të ishte raporti analitik financiar dhe po ti shikonim datat e faturave, do të thotë datën e faturimit, për to ndoshta nuk do vinim në përfundimet që u folën këtu sot. Unë nuk besoj që kryetari i ka shpenzuar 37.000 euro për këtë kohë vetëm telefon, unë besoj që janë pagesa bllok që janë bërë për një kohë më të gjatë. Fatkeqësisht, duke u mbështetur në raportin e auditorit, kjo po na përsëritet gjithmonë, po bëhen pagesa për vitet të mëparshme. E 2-ta... e 2-ta shqetësuese, prapë mbeten përparimet dhe është 1 vorbull që na nuk po mujm me dal prej tyre fatkeqësisht jashtë kontratës kolektive, vlera e tyre pjesa tjetër është pothuajse 3 fishi i asaj vlerës së kontratës kolektive dhe te njejtën kohë kisha 1 pyetje për fund, drejtoreshë kemi 3.823 euro e 84 cent pagesë për qira të automjeteve, për qfarë i kemi marrë këto automjete me qera, edhe për çka na janë nevojitur, faleminderit!

Hajdar Sutaj
Faleminderit Orges, dikush tjetër Shkëlqim Tolaj po urdhëro.

Shkëlqim Tolaj
Përshëndetje për të gjithë e kam një pyetje për kryetarin pasi që kanë mbetur vetëm 1.7 milion euro nga buxheti si mund të kryhet pagesat deri në fund të vitit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë Shkëlqim dikush tjetër, nëse ka dikush... Rifat Stojkaj drejtori i bujqësisë ka kërku fjalën.

Rifat Stojkaj
Faleminderit për fjalën kryesus, përshëndetje për të gjithë, realisht përgjigjen më të detajume dhe më specifike e dha drejtoresha e financave zonja Dafina Cacaj, meqenëse mu drejtua pyetja me emër e mora mundin mu përgjigj realisht drejtoresha e financave e ka miratimin edhe të kryetarit të komunes edhe të drejtorave që në rast se nuk ka mjete financiare me një kohë të caktume pagesën ta bëjë prej një kodi tjetër, sa i përket drejtorisë së bujqësisë, brenda këtij viti kemi vetëm 1 drekë zyrtare dhe kjo ka ndodhur javën e kaluar me rastin e panairit të produkteve bujqësore dhe ditën e gështenjës që kam qenë pagesa ka qenë vlerën diku 67 ose 68 euro. Nuk kemi asnjë pagesë tjetër që është realizu për dreka ose për darka zyrtare sa i përket drejtorisë së bujqësisë, por në rast se kjo duhet me qenë e arsyeshme, në rast se ndodh 1 pagesë, nuk ka mjete financiare në atë kod mundet me u bë pagesa prej drejtoris së bujqësisë për çështje që janë me interes për publikun faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj
Faleminderit, faleminderit drejtor dikush tjetër e shoh që nuk u lajmrua askush për fjalë. atëher ju e dini që ky raport nuk votohet vetëm diskutohet kështu që e kalojmë. Në pikën e 3-të është shqyrtimi i draft planit zhvillimor të arsimit 2024 2027. Ju i parashtruat pyetjet apo jo? faleminderit shumë. Jemi në pikën e 3 shqyrtimi i draft planit zhvillimor të arsimit 2024-2027 siç e dini ky draft plan ju ka nënshtruar gjitha, gjitha procedurave Që me ardh deri te diskutimi i sotëm edhe votimi ose mosvotimi i tij, por gjithsesi që e kemi diskutu edhe 1 herë do me thanë me i japë mundësinë që me iu nënshtru edhe diskutimit publik, E kemi prezent edhe drejtorin e arsimit, zoti Besnik Hulaj, kemi anëtarin e këtij grupi punues, profesorin, drejtorin e shkollës së mesme gjimnazit vllezërit Frashri e kemi këtu zyrtarin e lartë drejtorin Zeq Malaj poashtu më lejoni që ti përgëzoj edhe anëtarët tjerë të cilët sot nuk janë profesor doktor Ram Likën profesor Hysen Balaj, Ramiz Bajramaj, Enver Osdautaj, Afrim Balaj, Besart Cacaj, Jeton Hulaj, (.....) të cilët e kanë bërë këtë punë e cila sot është ardhë këtu për me marë edhe diskutimin edhe rekomandimet e juaja dhe aprovimi ose mosaprovimin e jua, prej grupit ...fillimisht drejtor a dëshiron diqka me than dikush prej juve Në rregull prej grupit të aleancës a don dikush diçka me thanë në lidhje me planin zhvillimor të arsimit të komunës, Arian Dobraj e ka fjalën.

Arjan Dobraj
Faleminderit kryesues meqenë se është shqyrtimi dhe miratimi i draft planit zhvillimor të arsimit, na si grup po besoj edhe komplet asambleja në disa raste kemi marrë pjesë në shumë diskutime të organizuar qoftv nga tka-ja, qoftë nga komuna e Deçanit bashkë me kryetarin Ramosaj diskutimet që kanë qenë vazhdimësi për përpilimin e këtij plani zhvillimor ku kemi dhënë ide ose sugjerime në ato diskutime edhe po besoj që është bo ni punë e mirë na si grup e përkrahim këtë plan zhvillimor falemnderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Arian, nga ldk-ja Miftar Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj
Faleminderit shumë kryesues lidhur me planin zhvillimor për arsim unë kam diskutu edhe në seancën e kalume dhe realisht i kam dhënë disa rekomandime për të cilat e pash që nuk janë të përfshira nëse kështu bëhemi real si dokument absolut që është dokumenti përshkruar mirë nëse gjen realizim për të cilat do të diskutoj në fund, për mu se dilema se vërejtje është test foto analiza nuk dyshoj që nuk ka të gjetura të sakta, por të kërcënimi për vlersimin tim një prej mekanizmav që kogja fort e kërcënon arsimin në komunën e Deçanit janë punësimet politike. Punësimet politike nëse nuk më dëgjove mirë kryetar, punësimet jo transparente dhe këtë ju a them me argumente, ne kemi djem dhe vajza në komunën e Deçanit për mos gjetjen e mundësisë së punësimit në shkollat e Deçanit u dal jasht, e ka lshu Kosovën ne kemi djem dhe vajza, e cila ka gradën master ta them qe don edhe kualifikimin e gjuhës angleze dhe nuk gjen mundësi me hy në shkollat e komunës së Deçanit për cilën ju e arsyetoni ose argumentoni programi të cilin e ka kry ne kohë të caktume ska qenë i legjitimum dhe ta them me përgjegjësi të plotë për të njëjtin program është i punësuar në shkollën fillore Isa Boletini në Isniq me të njëjtin drejtim. E 2-ta vrejtjet për të cilat unë i kam dhënë është adaptimi çerdheve me theks fshatin Isniq dhe fshatin Irzniq Unë drejtor po të kërkoj sot kështu në mënyr zyrtare nëse ka rekomandim nga ministria e arsimit që duhet dhe mund të akomodohet 1 çerdhe brenda objekteve ose lokale ose hapësirat e shkollës Isniq, kisha kërku që atë rekomandim na afron me shkrim. Unë s'kuptoj dhe s'munden me kuptu që mund të akomodohet nje çerdhe, brenda hapësirave te shkollës ku ne çerdhe ka dhe foshnjor. Ju e dini se foshnjorte edhe flenë, foshnjorët e dojn një qetësi tjetër, foshnjoret e dojn një ambient tjetër. Iisniqi e ka edhe parcellën për të cilën ne e kemi da në asamble komunale me vendim është e ndame parcella. Për fund te investimet absolut pajtohem nëse prap u thamë, nëse vërtet realizohen, shifrat janë goxha të larta shifrat të cilat janë pa projekte ju e dini që nesë është pa projekt është pak problem me u realizu nëse nuk gaboj vlera dikun për 3 vite është dikun mbi 3.5 milion pyetje konkrete a kan me u realizu këto projekte kryetar? Dhe për fund nëse nuk më keqkuptoni, pyetje ky raport që është hartuar, sa ka me i kushtu komunës së Deçanit, shërbimet intelektuale.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Miftar, nga vetevendosja Orges Tafilaj fjalën e ka kërku.

Orges Tafilaj
Faleminderit Kryesus, fillimisht duke filluar nga faqja e fundit, falenderim të gjith atyre që kanë punur në këtë plan, unë besoj që është obligim patriotik e kombëtar realizimi i këtij planit me gjithë mangësitë që po ceken nga kolegët të ndonjë mangësi tjetër. Pajtohem me parafolësin, që kur vije puna të punësimet, politika duhet të ketë larg duart dhe kjo është në interesin e përgjithshëm, gjithë neve po dhe gjeneratave të reja që po vijnë, sfidë jashta financimit, unë e besoj 1(nje) çështje, këtu është edhe raporti mes nxënësve dhe mësimdhënësve që fatkeqësisht numri i nxënësve po bije përditë edhe kjo jo vetëm për fajin tonë.
Njëjtën kohë, kisha kërku që anëtarët e komisionit që kanë qenë profesional të vazhdojnë angazhimin e tyre në përcjelljen e këtij plani deri në realizimin e plotë të tij, jo vetëm të angazhohen në këtë fillim si plan dhe kur të kalojë si dokument të mbetet i tillë, po të angazhohen edhe në 3 vitet e ardhshme, që ta jetësojmë planin në përgjithësi, faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Orges, Mon Selmanaj dëshironi me diskutu lidhur me pikën.

Mon Selmanaj
Po sigurisht

Hajdar Sutaj
Faleminderit

Mon Selmanaj
Faleminderit kryesues përshëndetje për anëtarët e komisionit që janë prezent Ky dokument i ofruar na paraqet 1 bazë të qëndrueshme me plot besim në një avancim të një strategjie, të një arsimi më cilësor në komunën tonë, gjithmonë duke u përshtatur me ligjin për arsimin në nivel shtetëror. Unë i përgëzoj hartuesit e këtij draft plani të cilët për mendimin tim kanë bërë një punë profesionale dhe të mundimshme, për çka edhe i

përgëzoj, megjithatë unë do të ndalem në faqen 12 ku flitet për sfidat të cilat janë hasur në përfshirjen e fëmijëve në nivelin parashkollor, në numrin e sfidave e keni cekur edhe kultura familjare. Mendoj që kjo fjalë këtu duhet të hiqet sepse është ofendim për qytetarët, në po të njëjtën faqe me posht te përshkrimi i sfidave të arsimit parauniversitar thuhet citoj, qasja konservative e komunitetit ndaj ndryshimeve në organizimin e rrjetit shkollor mbyllet citati ju lutem na zbërtheni këtë fjali sipas meje kjo fjali nuk ka vend në këtë plan është tepër e vrazhdë dhe aspak e kohës, sepse me asgjë nuk arsyetohet. analiza në faqe 13, në këtë analizë na paraqiten 4 shtylla, unë do të ndalem në 2 prej tyre te forcat dhe kërcënimet, te forcat faqe 13 në pasuesin e 2-të të kësaj shtylle thuhet citoj, angazhimi për të krijuar 1 marrëdhënie më të fortë mes komunitetit dhe institucioneve arsimore mund të ndihmojë në zgjidhjen e sfidave të kulturës familjare dhe në rritjen e përfshirjes në arsimin parashkollor. Mendoj se ky pasues duhet të hiqet sepse janë 1 mori faktorësh të tjerë që ju i keni përshkruar dhe që ndikojnë direkt në përfshirjen e fëmijëve në arsimin parashkollor, andaj kërkoj nga komisioni një sqarim se çka keni dashur të thoni me këtë, të paktën unë e di që nuk mund të ketë një angazhim të komunitetit dhe institucioneve arsimore që të zgjedhin sfidat në kulturën familjare. Te kërcnimet faqe 14 te kjo shtyllë, pasuesi i tret thotë, Kultura konservatore dhe rezistenca ndaj ndryshimeve të komunitetit mund të krijojë pengesa në implementimin e reformave arsimore dhe në përshtatjet me trendet e arsimit modern. Këtu kemi një paragjykim të shprehur nga komisioni se pengesë në reformën arsimore qenka kultura konservatore dhe rezistenca e komuniteti mendoj që për një konstatim të tillë duhet të na njoftoni me argumentet, lus komisionin ta shqyrtoj edhe një herë dhe mundësisht ta heqni nga argumentimi si kërcënim, këtu mund të ketë individë me një kulturë konservatore

Hajdar Sutaj
Mundesh me ja vazhdu fjalën i nderum

Mon Selmanaj
Këtu mund të ketë individë me një kulturë konservatore, por s'mund ti thuhet një komuniteti të tërë, dhe për fund dua ta falënderoj komisionin që ndër prioritetet e shkollave e ka paraparë edhe shkollën Rexhep Kadriaj në Rastavicë dhe rregullimin e kulmit të sallës së edukatës fizike, e cila ditëve me shi vërshohet nga uji, të nderuar kolegë të nderuar anëtarë të komisionit shpresoj të keni konsideratën dhe të përkrahni këto propozim ndryshime të ofruara dhe si të tillë me këto ndryshime të votojmë këtë plan zhvillimor ju faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë Mon, Albesa Cacaj e ka kërku fjalën.

Albesa Cacaj
Atëher pershendetje edhe një herë, mirënjohje për punën e gjithë grupit punues të cilët e kan hartuar këtë plan zhvillimor komunal për vitet e ardhshme, pyetja ime që i drejtohet drejtorit të arsimit në komunën e Deçanit është te faqja 11 pika 4 digjitalizimi i arsimit. I nderuar drejtor, e dini se të gjithë po jetojmë në kohën e digjitalizimit dhe mediave e rrjeteve sociale, po çështja që unë dua të shtroj sot edhe që kam ngrit dhe para pak ditësh edhe në rrjetin tim social ka të bëjë me infrastrukturën në objektin e shkollës fillore Lidhja e Prizrenit në Deçan, ka muaj ka vite që unë e ngris si çështje që është nevojë primare që ata fëmijë të cilët vijojnë mësimin në atë objekt janë kushtet e mjerueshme edhe këtë kisha dashtë kamera me e fokus qysh ka me mujt me u zbatu pika 4 digjitalizimi i arsimit në këto kushte edhe në këtë objekt? Këtë kisha dasht shum me e dit qysh ka mundësi në këtë objekt në këtë klas edhe që janë shumica e klasave të tilla me u përhap ose me vijue dixhitalizimi i arsimit faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë Vaton Istrefi e ka fjalën.

Vatan Istrefaj
Faleminderit kryesues, po ndalem pak tek investimet. Ku e shoh se për shembull tek shkolla fillore e mesme e ulët Bajram Curri pothuajse nuk ka kabinete përpos të atij të teknologjisë informative po ashtu karrigat brenda ulëset, dyer dhe gjithashtu infrastruktura e brendshme është pothuajse e demoluar e sho që tek investimet për këtë shkollë janë ndarë vetëm 6.000 euro,para shifen 6.000 euro e plani zhvillimor. A ka mundësi që këto investime pra të rriten në bazë të nevojës dhe këto nevoja të shifën për nga afër? Po ashtu drejtor nëse mundesh me na spjegu pak se ku kanë ngecur procedurat për ndërtimin e çerdhes në fshatin Strellc dhe desha ta cek 1 shembull të keq që e shohim kohëve të fundit për drejtor të shkollave ne e dimë se çdo qytetari i Deçanit ka të drejtë të votojë pa dallim subjekte politike, po ju si për shembull drejtor të shkollave të marrë 1

shembull të keq dhe shkojnë nëpër mbledhje partiake, aty ne ball të oxhakut, i dalin tonë para kryesisë partive politike. Është shembull i keq që mund të transmetohet tek nxënës tek mësimdhënësit tjetër etj. Mos i përdorni drejtorët e shkollave si kyçe politike pra në përmbledhje, nëse nuk keni njerëz tjetrë mos mbani mbledhje fare, por jo me drejtor të shkollav faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë se edhe nëpër gjitha subjektet politike, ka drejtor, e kanë lirinë e vet në atë punë, edhe ju keni drejtor të ministrisë së kulturës, që vjena në takime, a po kupton në ballë të sobës, ndoshta skeni ju nejse, kush është dikush tjeter, Teuta e ka fjalën.

Teuta Neziraj
Atëherë, 1 plan zhvillimor e arsimit për komunën tone, është gjithmonë i mirëpritur dhe i përkrahur nga të gjithë ne për përcaktimin e strategjisë dhe mënyrën se si duam të edukojmë brezat e rinj dhe për nivelin që duam të arrijmë në të ardhmen e afërt. Meqenëse këtu po e shoh që në kuadër te dka-s të funksionojnë edhe ekipe profesionale, ndërto është edhe ekipi për parandalim braktisje edhe mos regjistrim, pyetja ime ka të bëjë a kanë të dhëna të sakta në këtë vit shkollor? A ka braktisje të shkollës nga fëmijët dhe sa është numri i saktë i tyre nëse ka, dhe për çfarë arsye? Si edhe pyetja tjetër ka të bëjë që në faqen numër 8 në tabelën numër 2 përshembullsh mungesë në shumicën e shkollave të psikologëve dhe pedagogëve. Domethonë n'qoftëse numri i personelit në këto institucione është i manget, a kanë planifiku që ta plotësojnë stafin, sidomos me psikolog duke parë që jemi duke jetuar në 1 epokë ku është nevoja, sidomos tek fëmijët për psikolog nëpër shkolla.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Teuta dikush tjetër. atëherë meqenëse nuk ka të lajmruar për pytje ose komente, drejtori Po qe kryetari don me u përgjigj pastaj drejtori dhe anëtarët e grupit punues, kryetari Bashkim Ramosaj e ka fjalën.

Kryetari I Komunës, Bashkim Ramosaj
Përshëndetje, kryesus nuk po pretendoj me u përgjiëgj, po pretendoj me sugjeru dhe me lutë anëtrët e kuvendit që me jep leje dokumentit sepse ja vlen është një prej dokumenteve mat mir që ndoshta, që për një kohë bukur të gjat e kam lexu dhe e kam shqyrtu ndonjë herë kur bëhen ksi plane zhvillimore sikur krijohen strategji realisht përpos gjendjen reale i shpreh ato synimet ëndrrat që i ke për arsimin dhe është njëfar skeme që ti dëshrion pët të arrit, unë po besoj se si dokument është i nivelit tepër të lartë dhe nuk besoj se ndonjë komune e ka të nivelt të tillë, po falsim për nivelin komunal dhe për shkollimin parauniversitar dhe un po shfrytëzoj rastin me falenderu komplet komision për punën që e kanë bëre dhe për debatet e shumta që i kan organizuar që me dal një dokument, një dokument i tillë ndoshta pak ma me përmbajtje më shtytëtn për me fol edhe Moni edhe Teuta për shkak të përmbajtjes së dokumentit të cilin e bënë vlerësimit mbi këto edhe kur themi për qasjen konservatorët ne së paku e din nga praktika e dimë dhe për jetës edhe prej studimeve që çdo ndryshim ka me hasë në njëfar rezistence, janë do telashe krejt të natyrshe dhe po ashtu në rast se është fjala për qasjen konservate, unë nuk kisha thënë që me u hjek prej këti dokumenti, sepse ekziston kjo qasje. Ne jemi dëshmitarë të kohës, ata që kanë përcjellë organizimin e arsimit ndryshimet që kanë ndodhur në këtë gjithmonë ka pas njëfarë rezistence e kjo rezistencë është pak ma e thellë dhe është pak më konservatore, sidomos në qytetet e kalibrit të Deçanit sikur jemi dhe ne për shkak të traditës për shkakë të kulturës familjare që i kemi. Jo të gjithë pranojn me i qu fëmijët në qerdhe ose në foshnjore për shkak se pavarësisht se 2 bashkëshortë munden me punu dikund edhe nevoja është për me i pasë ata fëmijë në një qerdhe ose në një foshnjore Familja është ajo që në një farë mënyre kanë, ashtu është tradita dhe kjo traditë ndoshta vjenë një kohë qe nuk ka me egzistu do me thanë është shumë drejt edhe të metat edhe përparsit edhe sfidat edhe objektivat janë qartë të cekuna. Kur po flasim për braktisje këtë fenomen unë nuk jam i zoti por me spjegu po nëse braktisje i thojm edhe braktsije nga shkolla në kuptimin më klasik të fjalës kur dikush lënë mësimin krejt mirëpo braktisjen nëse mirret edhe këta njerz që e lëshojn Kosovën dalin jashta Kosovës është një numër shqetësus po ashtu edhe në rast se i mori zhvendosjen e popullsisë në shtetit edhe ky numër është poashtu po ashtu shqetësues. Kurse numri i braktisjes së shkollës për çfarëdo natyre të mundshme qoft edhe të hasmërive duhet me qenë të gëzuar se është në ramje e sipër, është inegzistent , shqetsimi më i madhi është kur, me sa kom pas rastin ndoshta po e keqpërdori këtë inforamt, drejtori ( ) Qorraj më ka treguar që e ka pasur këtë shqetsim kur nxënësat shembull kur prind shkojn me lajmru që këta fëmij nuk vijn më në shkoll për shkak që kan marrë një rrugë tjeter që dojn me lëshu vendin. Përmbajtja e këti dokumenti unë Ju garantoj që nuk ekziston me naj dokument me naj plan zhvillimor të arsimit të ndonjë komune tjeter është enkas për Deçan dhe un jam i sigurt me miratimin e juaj me fuqizimin e këtij dokumenti ka me u bërë model edhe për komunat

tjera për këtë jam i garantuar faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë kryetar, drejtori Besnik Hulaj e ka fjalën.

Besnik Hulaj
Faton me të thanë të drejten ato kritere janë ato kritere kushdo që është qyshdo që është, kuvendi thuhet që i ka 3 anëntar domethanë propozimin me ardh që kuvendi këtë rast shumicës i takojnë 2 Opozitës, opozitës 1 ekzekutive, drejtoria e arsimit kryetari kanë 1 edhe 1 prej shoqërisë civile domethanë nuk ka qenë këtu ideja domethonë, po shoh po me gjithëatë që unë e kërkoj një sqarim prej propozuesit të kësaj drejtor a ki mundësi një spjegim.

Besnik Hulaj
Përshëndetje edhe një herë për të gjithë, unë i kam votu kuvendin komunal që ta bëj komisionin për ndarjen e bursave, komisioni për ndarjen e bursave propozohet nga ana e kuvendi të komunës, në bazë të ligjit 05L20-2015. Komisioni për ndarjen e bursave, përbehet prej 5 anëtarëve që duhet të jenë 3 anëtarë të propozuar nga kuvendi i komunës, një anëtar nga shoqëria civile dhe një anëtar i drejtorisë së arsimit. Ku rekomandohet të jetë kryesues i komisionit për shkak të punëve tekniko-administrative, ky është komisioni për ndarjen e brusave, ndërsa te komisioni i ankesave duhet të jenë 5 anëtar, 2 anëtar nga kuvendi i komunës, 2 anëtar i propozon kryetari i komunës dhe 1 anëtarë nga shoqëria civile. Anëtarë të komisionit për ankesa nuk mund të jenë edhe anëtarë të komisionit për ndarjen e bursave.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë drejtor për sqarimet, atëherë ne i kishim këto propozime, pikërisht Qufaj dhe Arian Dobraj, kishim Albesa Cacaj, kishim Sanije Thaqi dhe Manjolla Shala.
Kush është për?
Urdhëro, a e keni dytë tash fjalën, a njeri prej juve?
Albesa Cacaj dhe Miftari, tërheket Albesa Cacaj.

Albesa Cacaj
Në rregull, unë e mbështes gjithë argumentimin që e tha zotëri Faton që është e rrugës dhe tradicionalisht sa e mbaj veten mend në kuvend gjithmonë kanë qenë të përfshira si opozitë e partitë që kanë numrin më të madh domethonë besoj që duheni me vlerësu që me kanë pjesë e këtij komisioni edhe 1 anëtar prej vetvendosjes sepse paraqet, është shumë më mirë e vlerësoj.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë Florim Mataj e ka fjalën.

Florim Mataj
Sa i perket ligjërisht jemi në rregull ashtu funksionon demokraci nëse në dëshirën tonë na mundemi me votu me ndryshu çkado që tash lutna kolege e nderume jemi ka flasim nëse don me kerku një nderë prej neve unë po pajtohna me ty këtu o problemi ama ligjërisht jemi në rregull vetëm këtë pjes ta ndajmë tash në aspektin tjetër që diskutojmë bashkarisht, gjithmonë e vendosim ndoshta na mundemi me propozu 2 anëtarë jo tshembull edhe mu hek krejt prej komisionit ajo pjesë tjetër ama veq dashta si procedurë jemi është në rregull ligjerisht kshtu e parasheh ligji kaq kisha.

Hajdar Sutaj
Kështu atëherë nëse ju jeni dakord që me rritë edhe 1 prej opozite, rritim edhe 1 prej pozite. E edhe 1 nga grupi i AAK-së e kështu më falni me çdo respekt dhe me mirëkuptim nuk po hijmë në situata që nuk më takojnë propozimi është ardhë është i kjartë propozuesit ja dhashë fjalën e spjegoi ligjin, e shpjegoi procedurën, nuk kërkoi për me ndryshue ose diçka nëse kemi ashtu, unë nuk më pengon kur kush më kon domethonë ashtu nëse doni me rritë, le të na spjegon drejtori e rritim numrin a lejohet a lejohet nuk e di nuk e kom të kjarte nëse lejohet e rritim numrin por dine rriten 1 numër ma të madh ka pozita i jepim 1 opozitës a po kupton sepse të gjitha herët proporcionalisht pozita shkon me më shumë njerëz.
Drejtor fjala për ty edhe 1 herë.

Besnik Hulaj
Edhe 1 herë përshëndetje për të gjithë ju jeni ata që e votoni komisionin asambleja unë jam drejtu me kërkesën bazë rregullores, por nëse shtoni si numër ju jini asambleja që mundeni me vendos. Po falemnderit shumë. Vetëm angazhim shtesë lypet prej juve se kurgjo ma shumë Faleminderit shumë edhe 1 propozim prej AAK-s Tash Florim ti the jemi dakord nëse thotë po Florim Mata e ka fjalën edhe niher.

Florim Mataj
Rregullorja e parashehë kështu dërsa thotë që mbetet në deshirën e juve. a doni me rrit a me ndrru numrin e anëtare të kominsionit kështu që aj është sponzorizusi ai duhet të kërkoj strikt prej neve, nese se parashe rregullorja me rrit pe rrisi duhet të jemi pak ma të kjartë kshtu qe veq ta ndajme këtë pjesë. nëse dojmë proceduralisht, nëse dojmë me atë aspektin tjetër kemi vendos gjithmonë qishtu gjithmonë vendosim qashtu demokracia rregullat parasheh parasheh kështu, jemi të vetëdijshëm të gjithë si funksionojnë gjithmonë grupit ma të madh i takon shumica nuk mundemi na me ndryshu kta, veq po du me kërku edhe prej drejtorit le të thote drejtori pe bojmë komisionin prej 7 anëtarëve, pe bojmë por ai le ta kërkon e jo le ta lejë në kompetencën tonë e tani me thanë mos me dal e përshkrume me than kështu me pru kështu.

Hajdar Sutaj
Faleminderit Florim edhe 1 herë drejtori Besnik Hulaj e ka fjalën.

Besnik Hulaj
Edhe një herë i nderum unë e kom pru kërkesën kërkesë e juaja ke jo e jemja me rrit numrin unë ju drejtova juve, ju jeni organe që e formoni komisionin, edhe ju vendosni vetë unë kërkesën e kom pru ju kërkesë juvja ke me rrit e jemja nuk u kanë me rritë. E jemja u ardhë strikte në letër, u ardh me kërkesë po e juaja ke. Kështu, si ju keni me formu.

Hajdar Sutaj
Por mos me ashtu ...e rritim komisionin për 2 anëtare që i bjen i patëm 3 prej kuvendit po i bëjmë 5 prej kuvendit, 3 pozita, 2 opozita propozon edhe 1 grup i AAK-së grupi ma i madhi edhe le ta propozojë edhe 1 prej opozite nuk jemi kundër kërkujt Po, Florim urdhno në rregull Lëndita, Lëndita Berisha prej opozite Vetëvendosja kon? Teuta Neziraj në rregull e qesë në votim. Fekri Qufaj, Lëndita Berisha, Arjan Dobraj, Albesa Cacaj, Teuta Neziraj, Sanije Thaqi, Manjolla Shala. Kush është për?
Kush është për se e qita në votim
A ka kundër?
A ka abstenim?
Faliminderit shumë e kemi miratu. Mon ka të drejtë njeri në demokraci edhe me propozu dikon edhe mu vet propozu për çdo pozitë a po kupton, te komisioni për ankesa 2 anëtarë kuvendin, një pozita , një opozita, 2 anëtaret le ti propozon drejtoria e arsimit edhe 1 prej shoqërisë civile mundet me propozu kjo dikond nga kolegët meqenëse është prezent herav të tjera le të marrin pjesë edhe të tjerët që janë në shoqëri civile

prezent grupi i AAk-s kënd e propozon Faruk Hasanramën faleminderit, nga opozita po Vatan Istrefaj e drejtoria e arsimit këndë e propozoni ju kënd e keni i nderuar 2 ne rregul ngritu lexoj Zeqë Malaj dhe Edona Kameraj e faleminderit prej shoqërisë civile profesoresha a ke ndokënd me propozu, Safete Gacaferi faleminderit shumë, atëherë kështu Faruk Hasanramaj, Vaton Istrefaj , Zeqë Malaj, Edona Kameraj dhe Safete Gacaferi.
Kush është për komision ankesav?
A ka kundër?
A ka abstenim
Faleminderit konstatoj që mënyrë unanime me 2 vota abstenim, të tjerët kanë qenë, për sa kan qenë E kemi themeluar edhe komisionin e ankesave, e kemi edhe te të ndryshmet këtë pikën që vendimi i datës 31.07.2024, në të cilën konstaton se kuvendi i komunës së Deçanit mbledhjen e mbajtur me këtë datë ka miratuar, nxirrni vendim numër 7/9 për ndryshim dhe plotësim të vendimit 01 numër 8/2 të datës 3.9.2015 edhe me arsyetimin se ky ligj nuk i parasheh ndryshimin e vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës per ndryshimin e sipërfaqës tokësore për rregullimin e objektit afarist banesorë, andaj bazuar në të lartcekurat, kuvendi i komunës së Deçanit duhet të ndërmarrë veprime ta rishqyrtoj aktin dhe të harmonizojë sipas legjislacionit në fuqi do të thonë kërkohet shfuqizimi i vendimit të datës 31.07.24 ka qenë fjala për 1 pronë dikund mes 2 objekteve të cilat i ka ndërtuar Gogaj dhe Likaj nëse nuk gaboj diçka po aty, a për likën diqka po aty se nuk po e di krejt
Kush është për?
A ka kundër?
A ka abstenim?
Faleminderit shumë me 3 vota abstenim e kemi shfuqizuar vendimin e datës 31.07.2024 a ka dikush tjetër te të ndryshmet me diskutu Vaton Istrefaj, pastaj Sylë Balaj po Vaton urdhëro

Vatan Istrefaj
Faleminderit për fjalën kryesues jo rastësisht dola në foltore, sepse në fillim të seancës rekomandova që pikat tek të ndryshmeve të bartet tek pika e parë e rendit të dites e jo e fundit. Kjo bjen si pasojë e saj, sepse ekzekutivi komunal ku po është pika më interesante për tek pika të ndryshme aty ku fillon debati çdo herë e marrin rrugë si të dalin nga asamblea dhe sidomos nga përgjigjen pyetjeve tona që i kemi si asamblist e kisha lutur dhe kameramanin që të merren me video incizim gjendjen e kuvendit komunal që është tani e kanë për respekt drejtori, drejtoresha e shëndetësisë, drejtori i bujqësisë, po ashtu drejtori i arsimit se gjithmonë qëndrojnë këtu. Unë personalisht i kam 3 pyetje dhe 2 kërkesa për kryetarin e komunës po kujt mi than tash kujt me ja bë këto pyetje spjegomani ju mu shikoni dhe kryesuesi bisedon tash sa un e maj fjalën këtu kjo është gjendja aktuale e kuvendit komunal Deçan na vetëm me fol ndërmjet veti si asambleista faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit faleminderit shumë drejtori Rifat Stojkaj e ka kërku fjalën, Vaton drejtori Rifat Stojkaj e ka fjalën, edhe tjetra e pata që errdhi dhe pyeti diçka dhe ju e dini që gjithkund ka drejtë gjithkush me shku te kryesuesi për tu konsultuar edhe përderisa je kon ka bisedon ti të tjerë kanë qenë, kërkoj falje po erdh kolega e patë një pytje unë nuk munda ti them largohu

Rifat Stojkaj
I nderuar kryesus i kuvendit, shumë të nderum anëtar të kuvendit komunal e mora mundin e mu përgjigj në emër të ekzekutivit meqenëse jemi për momentin 3 drejtorë këtu ky objekt ku jemi këtu fillimisht është tempull i demokracisë është tempull i përfaqësimit demokratik dhe tempull i përfaqësimit të qytetarëve të komunës dhe Deçanit. E gjuha me tendencë, gjuha me arrogancë, gjuha me baza politike jashtë rendit të ditës, jashtë përfaqësimit të interesave të qytetarëve nuk i takon këtij vendi dhe nuk i takon, as nuk i bën nder askujt. Kryetari i komunës së Deçanit i autorizon drejtorat e caktum me qenë pjesëmarrës nëpër senaca shumicën e seancave është pjesëmarrës, është prezent dhe e jepë përgjigjen qdo herë që ka nevojë me dhënë përgjigje dhe sa është i shtrohet ndonjë pyetje prej anëtarëve të kuvendit komunal ta ruajmë qetësinë e a ruajm gjakftotësin të jemi ata që na kanë votuar qytetarët me i përfaqësu interesat e tyne, edhe zërin e tyre, gjithë ata që janë të interesuar me u marrë me fushatë politike, fushata fillon në janar në janar le të dalin dhe të bëjnë fushatë politike. Këtu jemi edhe njëherë qëllimi kryesor është interesi i qytetarëve të komunës së Deçanit, forcat politike i masim zgjedhje, fatmirësisht qytetarët po e vlerësojnë edhe punën edhe për vlerësojnë individ dhe vlerësojnë partitë politike. Na jemi për ta këtu, per ta kem me punu, gjithë ata që kanë diçka tjetër vjen fushata, i ballafaqojmë argumentet edhe politike edhe për shkak të punës, faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj
Faleminderit, jo se nuk ta ka përmend emrin, kështu kolegë e patëm bërë në fillim, ndoshta ka qenë pak edhe gabim edhe i imi edhe i disa kolegëve që kemi hartu rregulloren për punë të kuvendit, se është dashur me planifiku më së mramti me shkrim, do të thotë mu dorëzu pyetjet edhe me ditë gjithë secili pyetjen se kështu e kanë shumica e kuvendeve, ndoshta krejt, po edhe kuvendi i Kosovës e ka, e parashtron fillim e patën bo mi paraqitet 3 ditë përpara edhe vishin edhe u përgjigjshin a po kupton, por por kjo nuk ke obligative, jo bën edhe kështu edhe ashtu në rregull po apet se apet per me i marrë përgjigjet gjith secili edhe mos më thonë, ashtu mundësisht bëni me shkrim të paktën 3 ditë, sjellni te un ose drejtoni direkt te drejtori drejtorit a kryetarit ashtu ose sillni në zyrat kryesuesit unë personalisht edhe kom me jau dorëzu dhe ku me kërku që me pasë përgjigje edhe gojarisht ne seanc dhe me shkrim nëse është nevoja, Miftar Ahmetxhekaj, Albesa Cacaj më falni Sylë Balaj e ka kërkuar fjalën para juve.. jo jo tashti Syla le të vazhdoj

Sylë Balaj
Atëher përshëndetje për të gjithë kjo situat është përkeqardhje ka 3-4 muaj që kam kërkesa të fshatit Isniq ku nuk mirren asnjë serioze as drejtori i shërbimeve publike ka 3 a 4 herë ku nuk ka kthy as përgjigje qa me ju than qytetarve ku ti adresojm problemet kryesus pasi drejtori i shërbimeve nuk është
(e ki egzekutivin tu pi kafe n dion e nuk vin me ndejt ketu qe foto live ma dergun do qytetar)
besom qe nuk është për fushat politike ka kërkesa shumë të mdhaja

Hajdar Sutaj
Jo se kam mbyllur po më falni 1 minutë ju keni drejt kushdo me ndejt unë e mbylli deri sat qendroni Albesa urdhëro

Sylë Balaj
kryesus nuk e perfundova.

Hajdar Sutaj
Në rregull vazhdo, e kjart e kjart Sylë a don me vazhdu, Miftar Ahmetxhekaj

Miftar Ahmetxhekaj
Kryesus meqenëse gjindem para një situate po them per vlesrimin tim jo të mir kem pak spo thom arrogancë po drejtorëve mirë është me qen une kur është aprovuar rregullorja e punës e kamë bërë një propozim ju te qesim te të ndryshmet por ta emërtojmë deklarimet jashtë rendit të ditës, tu jepet mundësia, kuvendarve asambleistëve që të bëjnë pyetje në fillim të seancës me qenë se drejtorët kanë kohë të gjatë edhe me u pregadit absolut pajtohem që ti bëjmë edhe me shkrim 1 rekomandim kryesues dhe unë e di që ti nuk ke nevojë për këshillat e mia, një kshill du me ta dhanë asambleist e aleancës mos të komentojn gjat deklarime tona ju jeni ata që udhëheqin seancën. Ju jeni ata që i krijoni rregullat në seancë asnjëherë në asnjë moment ne si asamblist nuk kundërshtojm dhe nuk ndërhyjm gjat fjalime të kolegëve tanë, është mirë ta kemi 1 praktikë edhe në formë të komunikimit që mos ta marrin rolin e kryesuesit këtij ti jepet fjala këtij mos ti jepet fjala jo të vazhdon, kështu apo ashtu ta krijojëm 1 praktikë, të paktën një edukat një paraqitje të mirë na tekefundit secili këtu jemi nga Deçani secili mund të jem prej fshatit dhe tek e fundit jemi bashkëvendas faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit dorën në zemër herën e fundit ndërhyni Vatoni që e publikoi që me telefon ashtu, e Albesa pastaj Florimi jo më fal një minut Albesa a ke diçka më thanë.
A din veç se përmbahuni degjoni njëri tjetrin mos të hym kështu, kështu pra, për shembull, në këtë rast ku ti jepet fjala e të lutna drejtohuni ne fjal pamvarsisht mos e dekoncentroni vetën urdhero

Albesa Cacaj
Dekoncetrojn te tjeret tek të ndryshmet duke provuar me i ik asaj qe paraprakisht ndodhi tek të ndryshmet kisha dasht po mungon drejtori i arsimit po tek të ndryshmet Tek të ndryshmet nuk mujta me parashtru, pse ndërhyn? Pse ndërhyn ky cila është nevoja e tij tek të ndryshmet i nderuar Kryesues -

Hajdar Sutaj
kuptoni një diçka moment që e merrni fjalën veq zani i personit që komunikon regjistrohet edhe kamera është

fokusuar te ai mos e humbni domethonë orientimin bisedoni thoni fjalën e juaj

Albesa Cacaj
Në rregull kryesus shpresoj ta përfundojë atëherë tek të ndryshme në muajin shtator në fund të muajit shtator, drejtori i arsimit ka sjellë 1 raport për fillimet e përgatitjeve dhe procesit mësimor. Ndër to, raporti ka qenë 1 fletësh dhe në fund të asaj flete ka qenë theksume se nuk ka braktisje të shkollës dhe të nxënësve nga ana e komunitetit nëpër shkollat e komunës së Deçanit dhe ne e kemi konstatu disa herë si komitet që jamë pjes e komitetit për komunitete, ka braktisje por drejtori e ka deklarue ka theksue, ka raportuar në raport se nuk ka kështu që ne ishim në shkollën Rexhep Kadrijaj ne Restavic dhe të pakten 7 nxënës nga komuniteti pakicë që nuk vijojnë shkollën në këtë shkollë, është ky numër domethonë sa për qartësi e shkollimi 9 vjeçar është i obligum me ligjet e republikës së Kosovës dhe juve si institucione institucioneve lokale ju bie përgjithësi që të merren me këtë çështje. Faleminderit veç ndoshta me konstatu qe nuk qëndron ajo që e tha, e ka thënë drejtori muajin shtator faleminderit.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë Florim Mataj e ka fjalën pastaj Faton Selmanaj

Florim Mataj
është mandati i dytë nuk kemi bërë kësi paragjykime këta e marrin të drejten me na sulmu edhe me na përdor shpesh herë na kur regojm diqka e lujn rrolin që smë duket i arsyeshum ne bëjmë diskutim gjith së bashku keni diskutu dhe kurr një her nuk ju ka ndërhy askush se ndërhyrja e kolegve pernime per mu është pak shqetësuse E din qe nga fillimi deri në fund thuajse shumicen e kohes flet opozita flasin diskutojn dhe ne e dim të gjith fillon fushata dalim Këtu janë rregullat e demokracisë këto janë rregullat e përfaqësimit, sepse nuk mundet nuk mundet me ma imponu është problemi që ka luftohet qe me na u imponu na me shku në bazë të grupeve parlamentare që e bën këtë rast ne kemi grupin tonë veprojmë sipas grupit tonë e jo sipas imponimeve me shku sipas tyre gabim e kanë jemi për gjitha por jo për imponim.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë Florim Faton Selmanaj pastaj e ka fjalën Faruki pastaj Armendi

Faton Selmanaj
Faleminderit kryesues, vërejtjet dhe rekomandimet, sugjerimet, si do thoni të kolegëve se cila ke me vend sepse me të vërtetë edhe kuvendi, respektivisht edhe qytetarët nuk po respektohen nga ekzekutivi, është veç 1 drejtor, i cili rrin çdo herë çdo seancë deri në fund patë apo nuk patë pyetje është Drejtori Rifat Stojkaj për të cilin edhe në kuvend duhet me pas rrespekt të veqant për të sepse është duke e rrespektu kuvendin përndryshe shiko ulset te gjitha janë të zbrazta edhe Besniku qenka kthyer tash, po nuk është rregull kjo kërkesa e kolegut Vaton ishte shumë e drejtë ose i vendosim pikat jashtë rendit të ditës në fillim Ose le të qëndrojën deri në fund të seancave, sepse mund të kemi pyetje, por kujt me ja bo ato pyetje, shembull sod për drejtorin Stojkaj skom as një pyetje kujt me ja drejtu ato pyetje kryesus sa i përket asaj se deklarove se sa me shkrim jo nuk mendoj që është korrekte me i sjellë pyetjet me shkri, Sepse pyetja mund të lind aty për aty ne mund të paraqitemi 3 ditë përpara që kem pytje me bo po jo me ta sjell pytjen se qa ko me të pyetë e ti me ardh i mirpregaditun për ato pytje kaq kisha.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë, Faruk Binakaj pastaj Armend Loshaj më falë Faruk Hasanramaj qa mu lidh me Faruk Binakin e ka një lënd time të aksidentit

Faruk Hasanramaj
Përshëndetje për të gjithë pata një pyetje për drejtorin Stojkaj a mundesh me na spjegu se kemi parë qe ka dalë aplikimi për sera, a mundesh të na spjegosh pak se e dimë të gjith se është në interes të qytetarëve?

Hajdar Sutaj
Drejtori Rifat, fjala për juve, faleminderit, të njëjtën pyetje e paska pasë dhe kolegu asambleisti Armand Loshaj faleminderit,

Drejtori,Rifat
Faleminderit për fjalën kryesus i nderuar asambleist Hasanramaj faleminderit për pytjen Po me date 28 e

komuna e Deçanit, respektivisht drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, ka nxjerrë 1 thirrje për aplikim për sera për fermerët tanë është thirrje sbashku me 1 organizate joqeveritare bamirëse Me anë të cilës pretendojmë të ndihmojmë mbi 50 fermerë me sera. Serat janë të tipit te mbyllur tipit tunel që thirret janë 20 me 5 me anë të cilët fermerët tanë aty mund të përgatisin dhe të jenë ti ken të gatshëm për treg e gjitha produktet që nga lamia e perimtarisë, është edhe 1 zotim edhe ni premtim që e kemi pasur bajagi qe një kohë kemi gjithë kohën, kemi gjetë mundësinë edhe me donatorë dhe mundësinë e pjesës financiare nga komuna e Deçanit një lajm i mirë për fermerët për fermerët tonë. Thirrja është e hapur nga data 28 deri më datën 11 të muajit nëntor të muajit që vjenë e gjithë qytetarët, gjithë fermerët që janë të interesuar të marrin pjesë dhe të aplikojnë janë hapur dhe të vijnë të aplikojnë pranë zyrave të drejtorisë së bujqësisë faleminderit për pyetjen nëse keni diqka tjeter sepse ka qenë temë eldhe ka qenë pjes e votume në kuvendin komunal për juve.

Hajdar Sutaj
Faleminderit shumë drejtor dikush tjetër a bon kështu e diskutum veq po e diskutoj un tash tek të ndryshmet si po e lëjmë punen e këtyre pyetjeve a ta marrin ndonjë vendim ti bëjmë me shkrim apo qysh po ja bëjmë ? po Albesë un veq po kom qef mi marrë përgjigjet që i ngritni

Albesa Cacaj
po me pyetje nform të shkrume dhe nuk kan japë rezultat prap shumica ke mbet pa përgjigje domethonë këtu vlen përgjegjësia që të jenë të pranishëm një herë në muaj është mbledhja

Hajdar Sutaj
Kështu, un jam kryesus kuvendi dhe ne jemi në demokraci këtu as nuk e kom rrolin e policit as të prokurorit as të gjykatsit as ndonja asambleist as ndonjë drejtor nuk mundem me sjell me zorë edhe me dashtë 26 anëtar këtu me bë kaos e bëjnë do me thanë na qe sjemi kapak vet me rrespektu njeri tjetrin e fjalën e mendimin nuk ka kush që mban rend jemi munduar mi kriju kushtet është transmetimi live duhet me pas kujdes se njërzit na shikojn edhe tjetra i kemi krijuar mundësi domethënë teknike e logjistike që më kanë më ashtu dhe në politik jemi ndonjëher edhe mbrenda subjekte kemi dallime të ndryshme e lëre më ne subjekte të ndryshme por nëse jeni dakord e kishim bërë që me i sjell 3 ditë pyetjet përpara edhe aty për aty masandej mundeni me pasë një diskutim shtesë a po kupton por me i obligu pak ta kemi këtë, në rregullore nuk e kemi nëse doni me lënë parimisht me ba le të ju mbetet juve nëse keni ndonjë mendim Mon a pate diqka me thanë, nëse pajtoheni qysh të doni spo e tham me patjeter

Mon Selmanaj
Kryesues mendoj qe është drejt ndoshta që një propozim që vije për ndryshim të rendit të ditës ose përshtim të një pike të veçantë rendi i ditës kjo mund të jetë kjo kështu, mirëpo. pyetjet që vijnë drejtpërdrejt, ndoshta ose shqetësimet nga qytetarët, sepse na përfaqësojmë qytetarët, nuk mund nuk mund ti parashikojmë prandaj ndoshta për momentin lind 1 pyetje për drejtora të caktum apo për kryetarin aty për aty dhe kjo mendoj se nuk duhet sanksionohet me këtë kusht. Prandaj duhet të jetë e hapur ne jemi shumë të vedishum që nëse propozojnë njërën ni pik për 1 renditje për ni çashtje caktume jam shumë i vetëdijshëm që ajo pikë duhet të vijë me shkrim edhe të jetë në kohën e parapame mu shqyqrtu nga kryetari nga drejtoria dhe nga ju si kryesuese të cilët e përpiloni rendin e punës faleminderit

Hajdar Sutaj
Faleminderit shum realisht e kam parë që kuvendi i Kosovës e ka këtë pikë, deklarimi jasht rendit të ditës Në fillim po ata i kan veq 10 minuta 10 minuta nuk e di as qysh i përzgjedhin nuk e di as procedurën kush e merr atë të drejt 10 minutat e para mi shpenzu a po kupton e për ata nuk e di qysh, se na mundemi me bë edhe ata me na marr kohë 2 orë, ma mir është me i lënë me diskutu sepse për neve është obligative me pëmbush planin e punës, pikat që janë të parapara me plan pune edhe qe hinë në rend të ditës edhe që votohen, po edhe ndonjë pikë që e keni, që e propozoni qe thoni këtë du me diskutu te të ndryshmet filon drejtori ka me dhanë përgjigje me thanë në fillim edhe me obligu për me qëndru, Florim qa pate me thënë

Florim Mataj
pika e parë që me bo pytje në spektin tjetër është ndoshta e drejt e drejtorin qe nuk deshiron me u pergjigj në seanc apo në seancën tjeter kështu që na te të ndryshmet, sod kur jemi kemi te drejt me parashtru pytje e kemi inqizimin drejtperdrejt jemi ja parashtrojm pytjet drejtorit të caktum kërkojm për seancën tjeter me u përgjigj në qoft se nuk përgjigjet kërkojm edhe për tjetren, kështu qe ne nuk mundemi sikur ësht e drejta jon

me bo pytje është edhe e drejta e drejtorit ndoshta nuk dëshiron me u përgjigj në atë pikë, kështu që drejten me na mohu nuke mundet askush.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë le të mbetet si rekomandim i kuvendit që drejtorat ata e kuptojn që e kanë obligative pjesmarrjen në seanc sikur e kan anëtarët e kuvendit por nëse kane ndonjë obligim munden për me ardhë në kohën kur ata e shohin në transmetim live që po afrohemi te pikat e te të ndyshme nëse nuk e kanë ndonjë pikë gjat gjith seances, po përcjellet edhe në transkript veç po shihet po dhe në procesverbale e kështu që mos të mungojn në mbledhjet tjera sepse nuk është një situatë këndshme as për mua, as për juve as po askënd me kaq e mbylli këtë mbledhje, mir u takofshim në mbledhjet e rradhës.

DEÇANI